



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2018:019710

Datë: 23.07.2018

Numri i dokumentit: 00086506

**P. nr. 508/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve K. dhe Z. Gj. qe të dy nga ... K Gjakovë, për shkak të veprave penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë në bashkëkryerje nga neni 333 /1-31 si dhe vepra penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188/2- 1-1.4-31 te KPRK-ës sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- Dep. përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.1970/14 të datës 25.08.2016, në shqyrtimin publik fillestar gjyqësor, të mbajtur më datë **20.07.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, mbrojtësit të akuzuarit K. Gj. av. N. D. dhe të akuzuarve K. dhe Z. Gj, te njëjtën dite mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

1.I akuzuari **K. GJ.** nga ... K Gjakovë, data e lindjes..., i biri i Z. dhe i A. e gjinisë T., ka të kryer shkollim universitar, menaxher i shitjes, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i dy fëmijëve, me ID ....

2.I akuzuari **Z. GJ.** nga ... K Gjakovë, data e lindjes...në fsh. .... K Gjakovë, i biri i N. dhe i M. e gjinisë L, ka të kryer IV kl te shkollës fillore, pensionist, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i dy fëmijëve, me ID ...

**J a n ë f a j t o r:**

**Sepse:**

**I –**

-me dt.09.10.2014 ,rreth orës 11.30 min., në Gjakovë, Rr....p.n., derisa i dëmtuari R. me bashkëshorten e tij kishte shkuar te shtëpia e mikut te tij qe te merret vesh me blerësin te akuzuarin K. lidhur me përmbushjen e kontratës te shitblerjes se shtëpisë, e kishte ndarë diku 5m nga shtëpia kamionetën me targ. Regj. ..., qe te bisedojë me te akuzuarit u ofrohen te xhipi me targa regj. .... ,e kur ofrohen te akuzuarit nga automjeti i fyejnë e i ofendojnë e me pas i akuzuari K. lëviz me Xhip ne drejtim tyre dhe i godet këmbëve,i dëmtuari R. hynë ne kamionetë qe ta largojë i akuzuari K. me xhip lëvizë nga pas e me pas lëvizë me shpejtësi para e me pjesën e parë ballore e godet kamioneten te cilën nga goditja e bartë pas disa metra dhe e përplasë ne një shtyllë betoni dhe i dëmton ,me pas i akuzuari

Z. përpiqet dhe e sulmon fizikisht ne kamionët qe ta godas te dëmtuarin R. S. nga Gjakova, por nuk arrin pasi qe ne vend lajmërohet dhe legjitimohet rastësisht një zyrtar policor jo ne detyrë e i cili edhe e ndërpre në sulmin .

**-me çka kanë kryer veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë ne bashkëkryerje nga neni 333/1-31 te KPRK-ës .**

## **II**

-me datë ,kohë dhe vend e mënyrë si ne piken e I- rë te aktakuzës ,nga goditja prej te akuzuarve me xhip ne kamioneten e te dëmtuarit dhe përplasja ne shtyllë e betonit te dëmtuarit R. SH. S. ,nga Gjakova i shkaktojnë lëndime te lehta trupore ,ndërsa Xh. S. nga Gjakova pa dëmtime trupore sipas ekspertizës mjeko ligjore te Dr. N. U. te dt. 24.04.2015.

**-me çka kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë truporë në bashkëkryerje nga neni 188/2-1 pika 1.4 -31 te KPRK-së**

Gjykata të akuzuarve K. Gj. dhe Z. Gj. ua përcakton **veç e veç për secilën vepër dhe atë:**

**I.** Për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë në bashkëkryerje nga neni 333/1-31 te KPRK-ës të përshkruar ne piken e I-re te dispozitivit i shqipton dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **90(nëntëdhjetë )ditësh,**

**II,** për veprën penale lëndim i lehtë trupor ne bashkëkryerje nga neni 188/2-1 pika 1.4-31 te KPRK-ës të përshkruar ne piken e II-të te dispozitivit , i shqipton dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **120 (njëqind e njëzet )ditësh** , i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1(një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,17,41,45,46,47,49,50,51,52,73,74, dhe nenit 333/1-31 dhe nenit 188/2-1-1.4-31 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPP-ës, i:

## **G J Y K O N**

**Të akuzuarin K. GJ.- dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjetë ) ditësh, i cili dënim me pëlqimin dhe kërkesën e mbrojtjes dhe të akuzuarit , i është zëvendësuar me dënim me gjobë ne shumen prej 900(nëntëqind) euro te cilën dënim është i detyruar ta paguaj ne afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë ) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit si dhe, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 120(njëqind e njëzet ) ditësh i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1(një) viti nuk kryen vepër tjetër penale .**

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, atëherë do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditësh .**

**Të akuzuarin Z. Gj. dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjetë ) ditësh, i cili dënim me pëlqimin dhe kërkesën e të akuzuarit, i është zëvendësuar me dënim me gjobë ne shumen prej 900(nëntëqind) euro te cilën dënim është i detyruar ta paguaj ne afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë ) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit si dhe, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 120(njëqind e njëzet ) ditësh i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1(një) viti nuk kryen vepër tjetër penale .**

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, atëherë do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditësh** .

I dëmtuari R.( Sh.).S. për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit qe ne mënyrë solidare ti paguajnë shpenzimet procedurale në shume prej **20,00** (njëzet) euro dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **60,00.-€** , në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore-DP në Gjakovë ,ka ngritë aktakuzën PP.nr.1970/14 të datës 25.08.2016të dt. 24.10.2016, kundër të akuzuarve K. dhe Z. Gj. nga fsh. ...K-Gjakovë për shkak të veprave penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë në bashkëkryerje nga neni 333 /1-31 si dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188/2- 1-1.4-31 te KPRK-ës.

Gjykata konstaton se me dt. 05.01.2017 ,ka marr aktvendim mbi pezullimin e shqyrtimit gjyqësor ndaj te akuzuarve K. dhe Z. Gj. qe te dy nga fsh. ... K Gjakovë , për shkak te pamundësisë se sigurimit te prezencës se tyre dhe ndaj te njëjtëve ka lëshuar urdhër arrest P.nr. 508/16 dt.05.01.2017.

Të njëjtit janë ndaluar në piken kufitare ne Verbnic dhe janë sjelle ne st. policor ne Gjakovë duke vepruar sipas urdhër arrestit me dt. 19.07.2018 , te njëjtit me dt.20.07.2018 janë sjelle ne lokalet e gjykatës me ç ‘rast te njëjtit do te procedohen dhe ndaj te njëjtëve do te tërhiqet urdhër arresti .

Gjatë shqyrtimit fillestar dhe publikë te mbajtur me të datë 20.07.2018, Prokurori i shtetit Ismet Tofaj, deklaroj se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës por ne dispozitivin e II-të te aktakuzës e benë precizimin e kualifikimit te veprës penale për shkak te lëndimeve te lehta trupore kështu qe kualifikimi duhet te jete me çka kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/2 lidhur me pra. 1 pika 1.4 të KPRK-ës .

I akuzuari K. Gj. , gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Nd. D. e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet si ne dispozitivin e I-re dhe te II-te te aktakuzës dhe atë duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprat e kryera ne afekt dhe nga një shqetësim emocional ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet , kërkojë falje për veprimet e kryera nga te dëmtuarit, i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë ,premtimi se ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, do te jem me i kujdesshëm si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ne ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë e nëse gjykata për ndonjëren vepër parasheh dënim me burgim e njëjta te me zëvendësohet me dënim me gjobë.

I akuzuari Z. Gj. , gjate shqyrtimit gjyqësor lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë për veprat penale për te cilën akuzohem dhe atë duke e ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer ne afekt ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet , kërkojë falje për veprimet e kryera nga te dëmtuarit, i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë ,premtimi se ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, do te jem me i kujdesshëm si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ne ndesh me ligjin te me shqiptojë



dhe dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 120(njëqind e njëzet ) ditësh i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse të akuzuarit brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1(një) viti nuk kryejnë vepër tjetër penale, me bindje e plotë se ky dënim është ne harmoni me peshën e veprave penale ,shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve , personalitetin e te akuzuarve dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj te akuzuarve do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 te KPRK-ës dhe gjykata beson se me shqiptimin e sanksioneve të tillë do të ndikoj tek të akuzuarit që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palëve te dëmtuara ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u muar konform nenit 463 te KPPK-ës.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bazohet ne dispozitën e nenit 450 par.1 dhe 2 nën par.2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.508/16 më datë 20.07.2018.**

**Sekretarja juridike  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes se tij ne dorëzim Gjykatës se Apelit ne Prishtinë.  
Ankesa ne kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.